

AKT THEMELIMI I EN-LO SHPK

Sot me date 01 / 06 / 2023, une i nenshkuari: Z. **Endrilon Cani**

I biri i Lufturi, lindur ne Burrel dhe banues ne Tirane, shpreh vullnetin per hartimin e ketij Akti Themelimi te Shoqerise **EN-LO SHPK** si me poshte vijon:

1. FORMA LIGJORE “ SHPK ”, eshte nje shoqueri tregtare me perjegjesi te kufizuar.

2. ORTAK I VETEM THEMELUES Ortak vetem, themelues i shoqerise eshte Z. **Endrilon Cani**

3. OBJEKTI Objekti i veprimtarise te shoqerise **EN-LO SHPK** eshte:

- Ushtrim i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit finanziar jo-banke **AK-INVEST sh.a.**
- Kembim Valutor
- Agjenci udhetimi

4. SELIA

Selia e shoqerise tregtare **EN-LO SHPK** do te jete ne adresen: Tirane, lokal ne ZK 8270, Bulevardi Shq. e Re, tel pallatet Agimi, dok. hip. Nr. 62.

5. KOHEZGJATJA

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per nje periudhe kohore te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar. Afati i permendur ne piken 1 te ketij nenii mund te shkurohet apo zgjatet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga Statuti i Shoqerise.

6. KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise tregtare **EN-LO SHPK** eshte 2.500.000 Leke (dy milion e peseqind mijë leke). Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 kuote dhe vlera nominale e nje kuote eshte 2.500.000 Leke (dy milion e peseqind mijë lek). Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjitha kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te tyre.



Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere. Cdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

7. ORTAKU I VETEM

Ortaku i Vetem ushtron kompetencat qe ligji i jep Asamblese se Ortakeve.

8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Shoqeria drejtohet nga Administratori. Administrator i pare i shoqerise
EN-LO SHPK eshte Z. Endrilon Cani

9. SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI

Shperberja dhe likuidimi i shoqerise tregtar mund te vije ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku ligjor, duke perfshire dhe falimentimin, privimin per te ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe te cdo faktori tjeter qe nuk varet nga vullneti i ortakeve te shoqerise.

Themeluesi

Z. Endrilon Cani

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Endrilon Cani". Below the signature is a stylized, handwritten name, likely a signature or a stylized version of the same name.

STATUT i Shoqerise tregtare EN-LO SHPK

Sot me date 01 / 06 / 2023

Kreu I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Forma ligjore dhe emri i shoqerise

- 1.1. **EN-LO SHPK** eshte themeluar bazuar ne ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare" i ndryshuar, si dhe ne Aktin e Themelimit te Shoqerise nenshkruar nga Ortaku i Vetem.
- 1.2. **EN-LO SHPK** eshte themeluar dhe funksionon si shoperi tregtare e formes "me perjegjesi te kufizuar" (sh.p.k). Nga ketu e meposhte ne kete Statut shoqeria **EN-LO SHPK** do referohet shkurtimisht Shoqeria.
- 1.3. Shoqeria fiton personalitetin juridik si dhe te drejten per te kryer veprime dhe te marre persiper te drejta dhe detyrime gjate aktivitetit te saj te perditshem, qe nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.
- 1.4. Shoqeria e realizon aktivitetin e saj, sipas objektit te pereaktuar ne kete Statut, bazuar ne Legislacionin Shqiptar, Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Neni 2

Ortaket e shoqerise

- 2.1. Shoqeria eshte themeluar nga një Ortak i vetem, Z. **Endrilon Cani**
- 2.2. Z. **Endrilon Cani**, si ortak i vetem, perjigjet per humbjet e shoqerise deri ne vleren e kapitalit themeltar te saj.

Neni 3

Kohezgjatja

- 3.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj, sipas objektit, per një periudhe te pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar.
- 3.2. Afati i permendur ne piken 1 te ketij nenii mund te shkurtohet apo zgjatet me vendim te Ortakut te vetem, ne perputhje me rregullat e percaktuara nga ky Statut.

Neni 4

Selia

- 4.1. Selia e Shoqerise **EN-LO SHPK** eshte ne adresen: Tirane, lokal ne ZK 8270, Bulevardi Shq. e Re, tel pallatet Agimi, dok. hip. Nr. 62.
- 4.2. Shoqeria mund te vendose te hape dege, filiale apo zyra perfaqesie ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise, si dhe jashte saj.



Neni 5
Objekti i aktivitetit

Objekti i aktivitetit te shoqerise **EN-LO SHPK** do te jetë:

- **Ushtrim i veprimtarise se transferimit te parave ne emer dhe per llogari te subjektit finanziar jo-banke AK-INVEST sh.a.**
- **Kembim Valutor**
- **Agjenci udhetimi**

Kreu II

KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 6

Kapitali themeltar


- 6.1. Kapitali themeltar i shoqerise tregtare **EN-LO SHPK** eshte 2.500.000 (dy milion e peseqind mijë) Leke.
- 6.2. Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote.
- 6.3. Vlera nominale e nje kuote eshte 2.500.000 (dy milion e peseqind mijë) Leke
- 6.4. Ortaku i vetem eshte zoteruesi i te gjitha kuotave te shoqerise, ne vleren 100% te tyre.
- 6.5. Kuotat jane nominative dhe nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere.
- 6.6. Cdo kuote perfaqeson te drejten e nje vote.

Neni 7
Regjistri i kuotave te kapitalit themeltar

- 7.1. Kuotat dhe zoteruesi i tyre, si dhe te dhena te tjera qe lidhen me kuotat e kapitalit themeltar, regjistrohen ne nje regjister te posacem.
- 7.2. Forma dhe modalitet e tjera te regjistrat miratohen me vendim te Ortakut te vetem.
- 7.3. Ne rast te zoterimit te kuotave te shoqerise nga me shume se nje ortak forma dhe modalitet e tjera te ketij regjistri miratohen me vendim te ortakeve qe zoterojne me shume se 3/4 e kuotave.

Neni 8
Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me vullnet te ortakut

- 8.1. Ortaku i vetem mundet te transferoje lirisht tek te tretet, pjeserisht ose teresisht, pjeset e kapitalit themeltar te shoqerise.
- 8.2. Ne rast se ne. nje moment te caktuar pjeset e kapitalit themeltar .te shoqerise zoterohen nga me shume se nje ortak, transferimi i ketyre pjeseve brenda shoqerise mundet te behet lirisht ndersa transferimi tek personat e trete mund te behet vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.



Neni 9

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi

- 9.1. Pjeset e kapitalit themeltar mundet te transferohen lirisht dhe pa asnje kluazole kufizuese ne kete Statut, nepermjet trashegimise, si dhe midis bashkeshorteve ne rast ndarje pasurore.
- 9.2. Pjeset e kapitalit themeltar mundet te transferohen lirisht dhe paasnje kluazole kufizuese ne kete Statut, midis bashkeshorteve si dhe midis prindit dhe femijes ose anasjelltas.

Neni 10

Akti i transferimit pjeseve te kapitalit themeltar

- 10.1. Ne cdo rast transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me vullnetin e ortakut duhet te vertetohet nepermjet nje akti notarial.
- 10.2. Trasferimet e pjeseve te kapitalit themeltar pasqyrohen ne regjistrin e posacem te miratuar sipas nenit 8 te ketij Statuti. Mos pasqyrimi i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar ne kete register, nuk e ben te pavlefshem aktin e transferimit.
- 10.3. Akti i transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar duhet te depozitohet ne Regjistrin Tregtar jo me vone se nje muaj nga data e regjistrimit te ketij akti ne zyrenoteriale perkatese.
- 10.4. Kerkesa per depozitimini e aktit te shitjes se pjeseve te kapitalit themeltar mundet te behet nga shitesi ose nga bleresi, ose prej perfaqsuesve te tyre te autorizuar.

Neni 11

Zmadhimet e kapitalit me ane te kontributeve ne para

- 11.1. Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet me kontribute ne para me vendim te ortakut te vetem.
- 11.2. Zmadhimi sipas pikes 1 te ketij neni behet me shlyerjen teresisht te vleres se shtuar prej Ortakut te vetem.
- 11.3. Shlyerja e fondeve mund te vertetohet nga nje zyre noteriale ose nepermjet nje konferme bankare.
- 11.4 Ne rast se zmadhimi i kapitalit nuk kryhet brenda 6 muajve nga data e depozitimit te fondeve, Ortakut te vetem i lind e drejta te terheqe fondet e depozituara.

Neni 12

Zmadhimi i kapitalit me ane te kontributeve ne natyre

- 12.1. Zmadhimi i kapitalit themeltar nepermjet kontributeve ne natyre behet me vendim te Ortakut te vetem.
- 12.2. Vlera e kontributit ne natyre si shtese e kapitalit themeltar percaktohet nga nje ekspert i cili emerohet nga Ortaku i vetem.
- 12.3. Te dhenat mbi kontributin ne natyre te shtuar si pjese e kapitalit themeltar pasqyrohen ne Statut dhe regjistrohen ne Regjistrin Tregtar. Ne rast te kundert zmadhimi konsiderohet i pa bere.

Kreu III

ORGANET DREJTUESE DHE TE ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE

Neni 13 Organet drejtuese

Organet drejtuese te shoqerise **EN-LO SHPK** jane:

- a. Ortaku i vetem
- b. Administratori

Neni 14
Ortaku i vetem, kompetencat

14.1. Ortaku i vetem ka keto kompetanca:

- a. ndryshimet ne dispozitat e statutit ka keto kompetanca;
- b. caktimi dhe shkarkimi i administratorit;
- c. caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/eksperteve kontabel si dhe likuidatorit/likuidatoreve;
- d. miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit;
- e. miratimi i raportit vjetor;
- f. shperndarja e dividenteve;
- g. ndryshimi i kapitalit themeltar;
- h. transferimi i kuotave te kapitalit themeltar tek palet e treta;
- i. likuidimi dhe/ose shnderrimi i shoqerise. ne nje forme tjeter

Neni 15
Administratori

15.1. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet:

- a. të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b. të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c. të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d. të kryejnë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- e. Miraton pagat mujore te gjitha kategorive te punamarresve, ne përputhje me tabelen e pagave te miratuar

15.2. Mandati i Administratorit të shoqërisë është 5 (pesë vjet) me të drejtë rizgjedhje.

15.3. Administrator i shoqërisë eshte **Z. Endrilon Cani**

ORTAKU I VETEM

Z. Endrilon Cani

Endrilon Cani

